

## FTESË

### **“PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET AZHBR DHE SUBJEKTEVE OFERTUESE TË CILËT JANË TË INTERESUAR PËR TË QENË PJESË AKTIVE NË REALIZIMIN E INVESTIMEVE TË PARASHIKUARA NË PROGRAMIN IPARD”**

Të nderuar,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është institucion publik, i krijuar bazuar në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, VKM Nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, është përgjegjëse për implementimin e Programit IPARD III “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, bashkëfinancim i BE dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me fond të përgjithshëm prej 146 milion euro.

AZHBR synon realizimin e një procesi eficient, transparent e të besueshëm në funksion të mbështetjes financiare të aplikantëve në fushën e bujqësisë, agropërpunimit, zhvillimit rural, etj. dhe përdorimin e shëndetshëm të fondeve të BE dhe Qeverisë shqiptare dhe mbrojtjen e interesave financiare të tyre.

Për këtë,

**Ju ftojmë në bashkëpunim për të qenë pjesë aktive në realizimin e investimeve të parashikuara në Programin IPARD III e cila do të ndikojë, përveç arritjes së synimeve të AZHBR-së, edhe në shtimin e mundësive tuaja për investime në Shqipëri.**

Për arritjen e këtij bashkëpunimi ju vëmë në dispozicion dokumentet e nevojshme që duhet të dërgoni, si më poshtë:

1. Certifikatë të regjistrimit të subjektit/Regjistri i firmës (për subjektet e huaja), sipas legjislacionit të tyre kombëtar;
2. Marrëveshje bashkëpunimi (tip) e nënshkruar nga ana juaj.

Për çdo pyetje e paqartësi mund të kontaktoni:

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural – Rruga “Muhamed Gjolleasha”, Nr. 56, Tiranë

Telefon, numri jeshil: 0800 83 83

Email: [cmime.reference@azhbr.gov.al](mailto:cmime.reference@azhbr.gov.al)

Për informacion mund të klikoni në web: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).